



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCES**

Tiranë, 26 Mars 2014

**NJOFTIM PER SHTYP**

**Raportimi në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit në lidhje me raportin e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2013 dhe prioritetet 2014.**

Komisioni i Konkurrencës nën drejtimin e Kryetares së Komisionit Znj. Lindita Milo (Lati) në vijim të raportimit të javës së kaluar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2013, ju pergjigj në seancën e sotme pyetjeve të deputetëve.

Pyetjet lidheshin kryesisht me funksionimin e tregjeve të produkteve baze të konsumit, inputeve bujqesore, kryesisht e plehrave kimike, tregun e gazit të lengshem, tregu i pullave fiskale dhe markimi i karburanteve, telefonisë së lëvizshme dhe shkallën e marrjes parasysh nga entet rregullatore të rekomandimeve të Autoritetit të Konkurrencës.

Në fjalën e saj, Znj. Milo u shpreh se Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të Ligjit ka monitoruar dhe hetuar funksionimin e tregjeve me qëllim sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive. Tregjet e produkteve bazë (përfshirë miellin, bukën, karburantet, gazin e lëngshëm, cigaret, vaji, sheqeri etj.) kanë qenë nën procedurat hetimore dhe mbikëqyrjen e Autoritetit, për të cilat Komisioni është shprehur me rekomandime për rivendosjen e konkurrencës, ose masa administrative (gjobë) në rastet e shkeljeve të konstatuara në formën e marrëveshjeve të ndaluara ose abuzimit me pozitën dominuese.

Autoriteti i Konkurrencës ka pershtatur instrumentat në drejtim të vendosjes së sistemeve të moderne të marrjes së provave në inspektimet e befasishme (*down raids*) duke trajnuar inspektorët në një program të BE-së dhe duke përdorur instrumentin e *Forensic* që kopjon dhe rikuperon të dhënat nga kompjuterat e firmës të cilat aksesohen më pas në ambjentet e Autoritetit.

Lidhur me pyetjen se çfarë mbështetje ligjore kërkohet nga Kuvendi, qeveria shqiptare dhe entet rregullatorë, Kryetarja e Autoritetit u shpreh se “duke falenderuar Kuvendin, dhe në mënyrë të posaçme Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, për ndihmën e vazhdueshme dhe produktive për aktivitetin e Autoritetit, do të kërkonim zhvillimin me tej të rolit proaktiv të Komisionit në drejtim të vendosjes në vëmendje të institucioneve të tjera qëndrore dhe vendore të detyrimit Ligjor të nenit 69 dhe 70 të ligjit “Për mbrojtjen e Konkurrencës” për të kërkuar vlerësimin e

Autoritetit për çdo projekt-akt normativ që sjell kufizime sasiore për hyrjen në treg, vendosjen e të drejtave ekskluzive dhe te veçanta, si dhe në sektoret e rregulluar, entet rregullatore duhet të krijojnë kushtet për një konkurrencë të ndershme dhe efektive”.

Në lidhje me tregjet e rregulluara ku kërkohet bashkëpunimi me entet rregullatore, znj. Lati u shpreh se tregjet e rregulluara kanë specifikë bashkëpunimin me rregullatorin dhe ky i fundit ka detyrimet e veta për të krijuar kushtet për funksionimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Në fjalën e tyre deputetët e Komisionit të Ekonomisë shprehen mbështetjen për aktivitetin e Autoritetit të Konkurrencës dhe kërkuan që entet rregullatore, qeveria shqiptare dhe të gjitha institucionet qëndrore dhe vendore të respektojnë detyrimin ligjor për të marrë paraprakisht opinionin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo akt që jep të drejta ekskluzive apo vendos kufizime sasiore për ndërhyrjen në treg. Deputetët u shprehën për priorizimin e aktivitetit të Autoritetit në tregjet kryesore si energjia elektrike, karburantet, telefonia celulare dhe sektorët ku janë dhënë të drejta ekskluzive si pullat fiskale, markimi i karburanteve, llotaria kombëtare etj.

**Në konkluzionet e seancave dëgjimore Kryetari i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave Z. Erion Braçe rikonfirmoi mbështetjen e të gjithë antarëve të Komisionit për Autoritetin e Konkurrencës dhe u shpreh se të gjitha entet rregullatore, ministritë dhe organet qëndrore dhe vendore duhet të mbajnë parasysht rekomandimet e Autoritetit dhe të kërkojnë vlerësimin paraprak të Autoritetit për aktet me karakter ekonomik.**

Gjithashtu u shpreh Z. Braçe është e papranueshme që sistemi gjyqësor zbeh progresin dhe cilësinë e vendimeve të Autoritetit të Konkurrencës për gjobitjen e kompanive nëpërmjet zvarritjes së proceseve gjyqësore dhe kërkoi informacionin nga Autoriteti i Konkurrencës për të informuar Këshillin e Lartë të Drejtësisë për këtë problematikë.

**Duke konkluduar Kryetari i Komisionit për Ekonominë dhe Financave rikonfirmoi mbështetjen për veprimtarinë e Autoritetit duke u shprehur se vetë Komisioni do të kërkojë vlerësimin paraprak për projektligjet që kanë impakt në konkurrencën në treg dhe se do të kërkojë edhe mendimin e Autoritetit për rezolutën që do t'i paraqesë së shpejti Kuvendit për të adresuar për zgjidhje sa më të qartë dhe më të plotë problematikën e ngritur në raportimin e Autoritetit dhe të diskutimeve të deputetëve për t'i vendosur tregjet në kushte konkurruese në një ekonomi tregu funksionale.**